



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.18, datë 28.04.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME  
POGRADEC SH.A.

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (*Ligji nr. 8102*), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (*VKM nr.958*), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (*Rregullore e licencimit*),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 28.04.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a.",

**Konstaton se:**

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a me shkresën nr.220 prot. datë 10.03.2023, plotësime me shkresën nr.289 prot. datë 31.03.2023 dhe plotësime për pagesën shtesë për licencimin me datë 18.04.2023 (me e-mail) me lëndë "Kërkesë për pajisje me licencë" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (*ERRU*) kërkesën për licencim.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (*KKRR*) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Pogradec sh.a në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (*VKM nr. 302*).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a (NUIS M24416601U) është themeluar më datë 26.07.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, Bashkitë Pogradec me 36.1%, Prrenjas me 12.9%.
  - b) Drejtues teknik i shoqërisë Z. Ferdinand Kullolli është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakulteti i Gjeologji Minierash, me Master i Shkencave në Universitetin Politeknik të Tiranës, Inxhinieri e Burimeve Natyrore, Profili Gjeomatike, në vitin 2011 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
  - c) Drejtues teknik i shoqërisë Z. Oltion Begollari është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknik, në vitin 2010 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
  - d) Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 100 499 banorë të Bashkive Pogradec, Prrenjas;
  - e) Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a deklaron se ofron shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura për ITUN Pogradec me një kapacitet për rreth 50,000 PE, për 40 000 banorë të qytetit të Pogradecit.
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Pogradec sh.a, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjetllësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
  - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Pogradec sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a me (NUIS M24416601U), në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
  - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura,

- c) Kategoria D - Për përpunimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
- a) Drejtues Ligjor – Johan Sterjo
  - b) Drejtues Teknik – Ferdinand Kullolli
  - c) Drejtues Teknik – Oltion Begollari
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a janë Bashkitë Pogradec, Prrenjas.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a për marrjen e këtij vendimi.
7. Vendimi i KKRR nr.191, datë 14.05.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Pogradec sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.345 date 21.09.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a”, shfuqizohet;.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**